



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2443/3 prot

Datë 26.10.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 1078 /2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.10.2023 me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-81573-09-28-2023, me objekt: “*Blerje Pesticide*”, me fond limit 1.998.000 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 09.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale, Durrës.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Egian Med” SHPK  
me Nipt. L71715003C dhe Adresë: *Njësia Bashkiake Nr. 7, Rr. Kavajës, “Condor Centre”, Kati 4, Tiranë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale, Durrës.  
*Adresa: Lagjja 4, Rruga Egnatia, Durrës*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së*

*Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 29.09.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-81573-09-28-2023, me objekt: “Blerje Pesticide”, me fond limit 1.998.000 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 09.10.2023 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “Egjan Med” SHPK, me numër ankimi elektronik A/2023/3472, datë 05.10.2023, dhe me nr. 2443/2023 prot., datë 05.10.2023 me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna

të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

III.4. Me shkresën nr.743/8 prot, datë 10.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2443/2 prot datë 13.10.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik “Egian Med” ShPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke e pranuar pjesërisht atë.

### III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton:

III.1. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues argumenton si më poshtë vijon: “[...] Në dokumentet e tenderit në Shtojcën 5 (Formulari i specifikimeve teknike) të DT, tek rubrika (Skicimet, parametrat teknik etj) është kërkuar:

NR	EMERTIMI I LENDËS AKTIVE	SPECIFIKIME TEKNIKE
1	<b>Insekticid</b> - Cypermethrine 10%	Gjendja fizike i lëngshëm. Produkt mikro kapsular për efekt të zgjatur. Ambalazhi do jete ne shishe 50-100 ml)
2	<b>Insekticid</b> - Cypermethrine 8%-10%+ Tetrametrine 1%-2%	Gjendja fizike i lëngshëm. Ambalazhi do jetë në shishe 50-100 ml.
3	<b>Rodenticid</b> - Bromadiolone 0,005%	Gjendja fizike-llokum/Block. Ambalazh qese 250 gr
4	<b>Herbicid</b> - Glyphosate 36%	Gjendja fizike i lëngshëm. Ambalazhi do jetë shishe 1Lt

Në dokumentat e tenderit në Shtojcën 6.

#### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emertimi i lëndës aktive	Njesia	Sasia
1	<b>Insekticid</b> - Cypermethrine 10%	Lt	50
2	<b>Insekticid</b> - Cypermethrine 8%-10%+Tetramitrine 1%-2%	Lt	300
3	<b>Rodenticid</b> - Bromedilone 0,005%	Kg	160
4	<b>Herbicid</b> - Glyphosate 36%	Lt	260

1. Për produktin 1 **Insekticid** - Cypermethrine 10% AK-ja ka përcaktuar vetëm specifikimet teknike gjendja fizike i lengshem. Produkt mikro kapsular per efekt te zgjatur. Ambalazhi do jete ne shishe 50-100 ml) dhe nuk ka asnjë argument se përse për AK është e rëndësishme që ky produkt të jetë vetëm në paketimet me shishe 50-100 ml, ndërkohë që në

shtojcën 6 (formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit) të DT, tek rubrika (sasia e mallit që kërkohet) për këtë produkt njësia matëse është litra.

Në treg këto produkte gjenden në paketimet duke filluar nga 50-100ml deri në 5 litra.

Për produktin **1 Insekticid** - Cypermethrine 10% AK ka kërkuar këtë produkt që të jetë vetëm në formën mikrokapsulare pa dhënë asnjë sqarim dhe argument se përse vetëm kjo formë e paraqitjes së produktit plotëson nevojat e AK-së.

2. Për produktin **Insekticid** - Cypermethrine 8%-10%+ Tetrametrine 1%-2%

AK ka përcaktuar vetëm specififikimet teknike: Gjendja fizike i lengshem. Ambalazhi do jete ne shishe 50-100 ml.dhe nuk ka asnjë argument se përse për autortetin kontraktor është e rëndësishme që ky produkt të jetë vetëm në paketimet me shishe shishe 50-100 ml ndërkohë që në shtojcën 6 (formulari i sasisë dhe grafikut te levrimit) të DT tek rubrika (sasia e mallit që kërkohet) për këtë produkt njësia matëse është litra.

Në treg këto produkte gjenden në paketimet duke filluar nga 50- 100ml deri në 5 litra.

3. Për produktin **Rodenticid**-Bromadiolone 0,005% AK ka përcaktuar vetëm **specifikimet teknike**: Gjendja fizike-llokum/Block. Ambalazh qese 250 gr dhe nuk ka dhënë asnjë argument se përse për AK është e rëndësishme që ky produkt të jetë vetëm në paketimin qese 250 gr. Ndërkohë që në shtojcën 6 (formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit) të dt, tek rubrika (sasia e mallit që kërkohet) për këtë produkt njësia matëse është kg. në treg këto produkte gjenden në paketimet duke filluar nga 50gr, deri 5 kg.

4. Për produktin **Herbicid** - Glyphosate 36% AK ka përcaktuar vetëm specififikimet teknike: Gjendja fizike i lengshem. Ambalazhi do jete shishe 1Lt dhe nuk ka asnjë argument se përse për AK është e rëndësishme që ky produkt të jetë vetëm në paketimin me shishe 1 Lt., Ndërkohë që në shtojcën 6 (formulari i sasisë dhe grafikut te levrimit) të dt, tek rubrika (sasia e mallit që kërkohet) për këtë produkt njësia matëse është litra. në treg këto produkte gjenden në paketimet duke filluar nga 1 litër deri në 5 litra, apo dhe në paketime më të mëdha.

Paketimet fikse apo shume të kufizuara të kërkuara nga AK si më sipër, për produktet objekt prokurimi, përjashtojnë nga pjesmarrja në këtë procedurë prokurimi të gjithë operatorrët ekonomikë të cilët kanë të drejtë të tregtojnë produktet e kërkuar në dt por, nuk i kanë këto produkte në paketimet e kërkuara nga ak-ja. Ndërkohë që kërkesa për këto lloj paketimesh, sjell përjashtimin e të gjithë OE-ve të cilët i tregëtojnë këtë produkte por me paketime të ndryshme nga ato të kërkuara nga ak-ja në dokumentat e tenderit. sikurse e cituam edhe më sipër këto lloj paketimesh nuk janë argumentuar në procesverbalin e hartimit të dokumentave nga ak-ja, se përse duhet të jenë pikërisht vetëm me këto paketime. përmasat e paketimeve nuk i sjellin asnjë problem AK-së, në raport me objektin e prokurimit, apo nuk çenojnë qëllimin për se kërkohen këto produkte, por dukshëm kufizojnë pjesmarrjen e operatorëve ekonomike.

Kërkojmë:

- AK të ndryshojë për të gjitha produktet objekt prokurimi kërkesat për paketim fikse duke hapur diapazonin e tyre dhe duke lejuar Të gjitha llojet e paketimeve me të cilat janë hedhur në treg këto produkte duke filluar nga paketimet 50 ml deri në 5litra për produktet me numra

rendore 1, 2 dhe 4 dhe dhe per produktin me numë rendor 3 **Rodenticid-Bromadiolone 0,005%** të lejohet paketimet duke filluar nga 50 gram deri në 5kg.

5.Gjithashtu Kërkesa e AK-së për produktin **Insekticid - Cypermethrine 10%** , që të jetë vetëm në formën mikrokapsulare pa dhënë asnjë sqarim dhe argument se përse vetëm kjo formë e paraqitjes së produktit plotëson nevojat e AK-së sjell gjithashtu kufizim të konkurrencës dhe pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë sepse këtë produkt në treg në formën e kërkuar nga AK-ja, vetëm mikrokapsulare e disponon në dijeninë tonë vetëm një kompani dhe në këtë mënyrë me anë të këtij specifikimi janë përjashtuar të gjithë operatorët e tjerë ekonomikë nga ky tender.

- AK të ndryshojë tek produkti **nr.1 Insekticid - Cypermethrine 10%** specifikimin teknik produkt mikro kapsularë duke mundësuar ofertën për këtë produkt edhe në format jo mikrokapsulare të këtij produkti.

III.1.1 Autoriteti Kontraktor me Vendimin Nr.743/8 prot., date 10.10.2023 të KSHA-së trajton ankesën me argumentat:

- Art 1. Sasia e mallit të kërkuar në cope nuk mund të barazohet me sasinë e mallit të kërkuar në litra. Nëse do të shprehej në copë- 300 cope \* 50 ml — 15 litra; 300 cope\* 60 ml= 180 litra; 300 cope\*70ml=21 litra; 30 cope\*80 litra=24 litra; 300 cope\*90 ml=270 litra; 300 cope\*100 ml=30 litra. Pavarësisht njësisë në ml që OE do të ofenojë, shuma e sasisë së kërkuar nga AK është 50 litra, çmimi duhet shprehur në litra.

- Art. 2. Sasia e mallit të kërkuar në cope nuk mund të barazohet me sasinë e mallit të kërkuar në litra. Nëse do të shprehej në copë- 300 cope \* 50 ml = 15 litra; 300 cope\* 60 ml= 180 litra; 300 cope\*70ml=21 litra; 30 cope\*80 litra=24 litra; 300 cope\*90 ml-270 litra; 300 cope\*100 ml=30 litra. Pavarësisht njësisë në ml që OE do të ofenojë, shuma e sasisë së kërkuar nga AK është 300 litra, çmimi duhet shprehur në litra.

- Art. 3. Sasia e mallit të kërkuar në cope nuk mund të barazohet me sasinë e mallit të kërkuar në kg Nëse do të shprehej në copë- 160 cope \* 50 gr — 8 kg ; 160 cope \* 6gr = 9.6 kg; 160 cope \* 70 gr = 11.2 kg ; 160 cope \* 100 gr = 16 kg ; 160 cope \* 150 gr = 24 kg ; 160 cope \* 250 gr = 40 kg. Pavarësisht njësisë në ml që OE do të ofenojë, shuma e sasisë së kërkuar nga AK është 160 litra, çmimi duhet shprehur në litra.

- Art. 4. Sasia e mallit të kërkuar në cope nuk mund të barazohet me sasinë e mallit të kërkuar në lit. Nëse do të shprehej në cope- 260 cope \* 1 lit = 260 lit ; 260 cope \* 2 lit — 520 lit; 260 cope \* 5 lit = 1300 lit. Pavarësisht njësisë në gr që OE do të ofertojë, shuma e sasisë së kërkuar nga AK është 260 lit. çmimi duhet shprehur në litra. Paketimet nuk janë kërkuar fikse por është lënë një tolerance nga 50 deri në 100 ml. Duke qenë se pompat për spërkatje që disponojmë në AK me të cilat do të kryhet trajtimi në ambjente të ndryshme kanë kapacitet deri në 20 litra ujë. Mallrat e kërkuar duhet të treten në ujë për tu përdorur, sa më e madhe të jetë sasia në ml aq më madhe është sasia e ujit që do të tretet. Kemi të bëjmë me produkte të cilat konsiderohen të rrezikshme dhe derdhja në ambjent e tyre, aq më tepër në përqëndrimin që kanë në paketimin origjinal, shkakton helmim për njerëzit, kafshet dhe organizmat ujore. AK e realizon këtë procedurë prej shume vitesh, dhe paketimet e mëdha kanë shkaktuar problem në ambientin e punës pasi ka pasur raste që ka pasur rrjedhje dhe derdhjet e paketimeve të hapura duke

shkaktuar konfuzion për punonjësit e ndërmarrjes dhe aromë të rënde pasi ambienti ku magazinohen këto produkte është në të njejtën ndërtesë me zyrat e administratës. Një arsye tjetër pse AK kërkon paketime të vogla janë rastet kur trajtimi me këto produkte bëhet në ambiente të vogla të cilat kërkojnë me pak se 20 litra ujë tretësirë. Në këto raste punëtori i shërbimit duhet të kthejë në magazinë sasinë e mbetur të produktin, por është e pamundur për magazinën të bëjë hyrjes sasinë e mbetur apo dalje aq sasi produkti sa do ti duhet punonjësit të shërbimit për të kryer shërbimin, pasi kemi të bëjmë me produkte helmuese të cilat duhet të magazinohet në paketimet e tyre të posaçme për shkak të toksicitetit. Paketimet e vogla janë domosdoshmeri per AK per arsye se ne nuk disponojme pajisje me depozita më të mëdha se 20 litra dhe kjo është e vetmja mënyrë për të shmangur derdhjen e produkteve të përqendruara në ambientet e punës, shmangur raste e helmimit, apo për të kontrolluar gjendjen e magazinës.

- Ankesa e Operatori Ekonomik Egian Med shpk pranohet pjesërisht duke modifikuar specifikimet teknike si me poshte:

- Ishte:

NR	EMERTIMI I LENDES AKTIVE	SPECIFIKIME TEKNIKE
1	<b>Insekticid</b> - Cypermethrine 10%	Gjendja fizike i lëngshem. Produkt mikro kapsular per efekt te zgjatur. Ambalazhi do jete ne shishe 50-100 ml)
2	<b>Insekticid</b> - Cypermethrine 8%-10%+ Tetrametrine 1%-2%	Gjendja fizike i lëngshem. Ambalazhi do jetë në shishe 50-100 ml.
3	<b>Rodenticid</b> - Bromadiolone 0,005%	Gjendja fizike-llokum/Block. Ambalazh qese 250 gr
4	<b>Herbicid</b> - Glyphosate 36%	Gjendja fizike i lëngshem. Ambalazhi do jete shishe 1Lt

- Bëhet

NR	EMERTIMI I LENDES AKTIVE	SPECIFIKIME TEKNIKE
1	<b>Insekticid</b> -Cypermethrine 10% ose Insekticid për përdorim në shëndetin publik lëndë aktive ekuivalente, pjesë e listës së VKM-së Nr. 933, datë 25.11.2020 me % jo më të lartë se 10%.	Gjendja fizike i lëngshëm. Produkt mikro kapsular per efekt te zgjatur. Ambalazhi do jete ne shishe 50-100 ml ose në shishe me një sasi lëngu që tretet në jo shumë se 20 litra në ujë.
2	<b>Insekticid</b> -Cypermethrine 8%-10%+ Tetrametrine 1%-2% ose produkte të tjera ekuivalente për përdorim në shëndetin publik lëndë aktive ekuivalente, pjesë e listës së VKM-së Nr. 933, datë 25.11.2020 me % jo më të lartë se 10%.	Gjendja fizike i lëngshem. Ambalazhi do jete ne shishe 50-100 ml ose në shishe me një sasi lëngu që tretet në jo shumë se 20 litra në ujë.
3	<b>Rodenticid</b> -Bromadiolone 0,005% ose për përdorim në shëndetin publik lëndë aktive ekuivalente të gjeneratës së II të antikoagulantëve, pjesë e listës së VKM-së Nr. 933, datë 25.11.2020 me % jo më të lartë se 0,005%.	Gjendja fizike-llokum/Block. Ambalazh qese 50 gr ose 250 gr.
4	<b>Herbicid</b> - Glyphosate 36%	Gjendja fizike i lengshem. Ambalazhi do jete shishe 1Lt

Gjithashtu Autoriteti Kontraktor me Vendimin Nr.743/8 prot., date 10.10.2023 të KSHA-së trajton pretendimet mbi formen mikrokapsulare me argumentat:

*“Ju sqarojme si me **poshte vijon:** Nga konsultimi me specialistet e ndermarrjes sone, Mikrokapsulat i japin formulimit nje qendrueshmëri të gjatë duke u çliruar me vonesë dhe eliminojnë aromat e pakendshme. Çlirimi me vonesë i mikrokapsulave në prani të dritës bën te mundur që ky produkt të kete efekt me te gjate dhe për pasojë në disa ambjente sensitive siç janë ambjentet e çerdheve dhe kopshteve efekti kundër insekteve zvarritëse dhe fluturuese të jetë më i zgjatur duke shmangur nevojën për trajtime të shpeshta. Ju kujtojmë se jemi një qytet bregdetar ku prania e insekteve për shkak të lagështisë, dhe e mushkonjave në vecanti, është shume e larte. AK e realizon këtë procedurë prej shume vitesh dhe zgjidhje për ambientet sensitive kanë qenë vetem ato produkte me formulim mikrokapsular. **Theksojme se per sigurine shëndetësore të fëmijeve produkti mikrokapsular do të përdoret në ambiente të brendshme.***

III.1.2. Autoriteti Kontraktor ka publikuar në SPE shtojcën 5 dhe shtojcën 6 si vijon:

**Shtojca 5.** [ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

*SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*

NR	EMERTIMI I LENDES AKTIVE	SPECIFIKIME TEKNIKE
1	<b>Insekticid</b> - Cypermethrine 10%	Gjendja fizike i lengshem. Produkt mikro kapsular per efekt te zgjatur. Ambalazhi do jete ne shishe 50-100 ml)
2	<b>Insekticid</b> - Cypermethrine 8%-10%+ Tetrametrine 1%-2%	Gjendja fizike i lengshem. Ambalazhi do jete ne shishe 50-100 ml.

3	<b>Rodenticid-</b> Bromadiolone 0,005%	Gjendja fizike-llokum/Block. Ambalazh qese 250 gr
4	<b>Herbicid</b> - Glyphosate 36%	Gjendja fizike I lengshem. Ambalazhi do jete shishe 1Lt

**Data e skadences te jete e dukshme**

**Afati te jete jo me pak se 2 (dy) vit nga data e levrimit.**

**Pesticidet te jene te zhdoganuara.**

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

Nr	Emertimi i lëndës aktive	Njesia	Sasia
1	<b>Insekticid</b> - Cypermethrine 10%	Lt	50
2	<b>Insekticid</b> - Cypermethrine 8% -10%+Tetramitrine 1%-2%	Lt	300
3	<b>Rodenticid</b> - Bromedilone 0,005%	Kg	160
4	<b>Herbicid</b> - Glyphosate 36%	Lt	260

**Pershkrimi i kerkesave te zbatimit te sherbimeve ne lidhje me to:**

- Malli do të levrohet nga operatori ekonomik që do shpallet fitues i cili duhet të njoftojë 1 ditë përpara për levrimin e mallit, ku të përcaktohet sasia, njësia dhe emri i shoqëruesit të mallit.
- Malli do te dorezohet ne prani te komisionit te marrjes ne dorezim ne Magazinën e NSHK Durres, lagja 4, rruga Egnatia.

Furnizimi do të bëhet 10 dite nga nenshkrimi i kontrates, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues

III.1.3 Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një



fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet

*ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”.*

Në Pikën 1, 2 dhe 7 të VKM Nr. 487, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin e produkteve biocide”, përcaktohet se:

[...]

*1. Personat fizikë ose juridikë, që aplikojnë për autorizim për vendosjen në treg dhe për përdorimin e produkteve biocide në territorin e Republikës së Shqipërisë, klasifikojnë, etiketojnë dhe ambalazhojnë produktet biocide sipas përmbledhjes së karakteristikave të produktit biocid, në përputhje me përcaktimet për rrezikun e kujdesin dhe me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 27, datë 17.3.2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, dhe në vendimin që rregullon klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve. Përmbledhja e karakteristikave të produktit biocid bëhet sipas legjislacionit për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedurën e dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide.*

*2. Sipas objektit të veprimit, produktet biocide klasifikohen në 22 tipa produktesh biocide, të grupuara në 4 fusha kryesore sipas shtojcës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.*

...

*7. Çdo lëndë biocide duhet të jetë e pajisur me etiketën përkatëse në gjuhën shqipe. Në etiketë duhet të përmbahen në mënyrë të lexueshme, lehtësisht të kuptueshme dhe të pashlyeshme këto elemente:*

*a) emërtimi dhe përqendrimi i çdo lënde aktive në sistem metrik;*

*b) nanoproduktet që mund të përmbahen, çdo risk specifik të lidhur me to dhe pas çdo reference për nanomaterialet vendoset fjala “nano” në thonjëza;*

*c) numri i autorizimit të produktit biocid, dhënë nga autoriteti kompetent;*

*ç) emri dhe adresa e mbajtësit të autorizimit;*

*d) tipi i formulimit;*

*dh) **përdorimet për të cilat është autorizuar;***

*e) **udhëzime për përdorimin, dozat dhe frekuenca e aplikimit, shprehur në njësi metrike në mënyrë të kuptueshme për përdoruesin, për secilin përdorim për të cilin është dhënë autorizimi;***

*ë) të dhëna për efektet e mundshme anësore, direkte ose indirekte, udhëzime për ndihmën e parë;*

*f) nëse shoqërohet me fletë shpjeguese, vendoset fjalia “Përpara përdorimit lexoni instruksionet*

*bashkëngjitur” dhe, aty ku aplikohet, të ketë paralajmërime për grupet vulnerabël;*

*g) udhëzime për nxjerrjen e sigurt jashtë përdorimit të produktit dhe ambalazhit të tij, përfshirë ndalimin e përdorimit të ambalazhimit, kur kjo është e përshtatshme;*

*gj) numrin e lotit ose identifikuesin e produktit, sasinë neto, datën e prodhimit, datën e skadencës në kushte normale ruajtjeje;*

*h) kur është e aplikueshme, periudhën e kohës që nevojitet për efektin biocid, intervalin për t’u observuar midis aplikimeve të produktit biocid, ose midis aplikimit dhe përdorimit të produktit të trajtuar ose aksesit të njerëzve ose kafshëve në zonën ku janë përdorur produktet biocide, përfshirë anë të veçanta lidhur me mjetet dhe masat për dekontaminimin dhe kohëzgjatjen e*

nevojshme të ventilimit në zonat e trajtuara; të dhëna për pastrimin e mjaftueshëm të pajisjeve, të dhëna lidhur me masat mbrojtëse gjatë përdorimit e transportit;

i) ku është e aplikueshme, kategoritë e përdoruesve për të cilën produkti biocid është i kufizuar;  
j) ku është e aplikueshme, informacion mbi ndonjë rrezik të veçantë për mjedisin, në veçanti për mbrojtjen e organizmave jotarget dhe shmangien e ndotjes së ujit;

k) produktet biocide që kanë në përbërjen e tyre agjentë biologjikë etiketohen duke përdorur shenjën “biohazard”, të paraqitur në shtojcën II, të vendimit nr. 550, datë 27.8.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores, “Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punë-marrësve nga risqet e lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë në punë”” dhe të tjera shenja paralajmëruese përkatëse. [...]

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të

përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionalë sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt- kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet *“Specifikime teknike”* janë: a) *në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”*

Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njëherë nga sa vijon: b) *në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim*

*në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

Gjithashtu, nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë, që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të parashtrojnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” është përafuar pjesërisht edhe me Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar”. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): "Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar". Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, që bie në kundërshtim me LPP, mund ta kundërshtojë këtë vendim.” Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor, si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson, se fakti se nëse një ose disa produkte të një ose disa prodhuesve vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor, nuk përbën një kusht sine qua non, se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuarit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së

*Shqipërisë*”, në të cilin parashikohet se: “në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë, se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtarë me reputacion.

III.1.5. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

Sa më sipër, KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentesh, me qëllim përfitimin e një malli apo shërbimi me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë se autoriteti kontraktor në asnjë moment në specifikimet teknike dhe termat e referencës, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendë asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” dhe referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit dhe Shtojcës 5 “*Formulari i specifikimeve teknike*” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme, që të përcaktojë, se produktet që do të përdoren, plotësojnë karakteristikat teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit dhe përmes kësaj të sigurohen produkte cilësore që shërbejnë për arritjen e qëllimit dhe përmbushjen me sukses të kontratës.

Gjithashtu, referuar kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor në lidhje me pretendimet mbi specifikimin teknik më sipër, AK nuk ka arritur të argumentojë teknikisht vendosjen e specifikimeve të tilla, pasi specifikimet teknike në kuptim të nenit 36 të *lex specialis* duhet të jenë të qarta, të sakta, të mirëargumentuara dhe të mos orientojnë drejt një marke apo emri tregtar të caktuar. Është e vërtetë që autoriteti kontraktor po e ble mallin, por operatori ekonomik nuk mund të jetë në kushtet e paqartësisë të përdorimit të këtyre mallrave, pasi operatori ekonomik në momentin kryesor në përgatitjen e ofertës teknike duhet të jetë i qartë për produktin që oferton.

Autoriteti kontraktor në trajtimin e ankesës nuk është bindës me argumentat e tij në lidhje me ndarjen sasiore të porcioneve të artikujve objekt prokurimi. Kërkesat për paketime të vogla vështirësojnë operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave dhe lëvrimin e mallit, ndërsa për

autoritetin kontraktor është e rëndësishme përbërja e artikujve Insekticide dhe efektshmëria e tyre në përdorim.

Komisioni i Prokurimit Publik nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes vëren se është detyrë e përdoruesit të marrë sasinë e duhur në kohën e përdorimit në proporcion me sipërfaqet e planifikuara për tu përdorur. Komisioni gjykon se përsa kohë ndarja në paketime në sasi të vogla të artikujve pesticide nuk ndikon në cilësinë e produktit të kërkuar, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike në lidhje me amblazhimin e produkteve të kërkuara objekt ankimi.

Për sa referuar më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

III.1.6 Përsa i përket pretendimit të ankimuesit mbi Kërkesën për produktin Insekticid - Cypermethrine 10% , që të jetë vetëm në formën mikrokapsulare pa dhënë asnjë sqarim dhe argument se përse vetëm kjo formë e paraqitjes së produktit plotëson nevojat e AK-së sjell gjithashtu kufizim të konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë sepse këtë produkt në treg në formën e kërkuar nga AK-ja, vetëm mikrokapsulare e disponon në dijeninë tonë vetëm një kompani dhe në këtë mënyrë me anë të këtij specifikimi janë përjashtuar të gjithë operatorët e tjerë ekonomikë nga ky tender Komisioni vëren se specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Autoritetin kontraktor me hartimin e specifikimeve teknike duhet të mundësojë pjesëmarrjen e një numri të gjerë konkurrentësh, me qëllim përfitimin e një mallit apo shërbimi me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë, se autoriteti kontraktor në asnjë moment në specifikimet teknike dhe termat e referencës, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendë asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces të veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Referuar trajtimit të ankesës nga autoriteti kontraktor, në lidhje me pretendimet mbi specifikimin teknik për produktin **Insekticid - Cypermethrine 10%** , që të jetë vetëm në formën **mikrokapsulare**, Autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht vendosjen e një specifikimi të tillë, pasi specifikimet teknike në kuptim të nenit 36 të *lex specialis* duhet të jenë të qarta, të sakta, të mirëargumetuara dhe të mos orientojnë drejt një marke apo emri tregtar të caktuar. Në këtë kuadër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të sqarojë se në cilën bazë ligjore është hartuar ky specifikim teknik, autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë argumentim teknik bindës së përsë një formë e caktuar ka efekt më shumë sesa forma tjetër kur përbërja kimike është e njëjtë. Për efektshmërinë e produktit ka rëndësi përmbajta e tij e jo forma.

Komisioni gjykon se, për sa kohë forma e artikullit **Nr 1. Insekticid - Cypermethrine 10%** , **Produkt mikrokapsular per efekt te zgjatur** nuk ndikon në përmbajtjen apo edhe në cilësinë e produktit të kërkuar, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike në lidhje me formën duke vendosur *termin ekuivalent* në lidhje me formën e produktit Nr.1 objekt ankimi.

Për sa referuar më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.2. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues me pretendimet si vijon:

[... AK nuk ka argumentuar në procesverbalin e hartimit të dokumnetave të tenderit se **përse kërkohen produkte vetëm më një lëndë aktive dhe për më tepër më përqindje shume fikse të kësaj lëndë aktive** ndërkohë që qëllimin e AK-së mund ta realizojë më së miri edhe produkte të tjera të cilat kanë **lëndë aktive ekuivalente** me atë të kërkuar nga AK-ja dhe me përqindje të ndryshme të këtyre lëndëve aktive. Vendosja e kriterëve të tilla është e pabazuar në ligj dhe rregulloren e BE dhe ECHA; tek të cilat lëndët aktive në përdorim në fushen e shëndetit publik, nuk kanë vetëm një përqendrim dhe diapazon të caktuar të % sic e kërkon ju, por përqendrimi i lëndë aktive në përbërje të produktit biocid lejohet të perdoret në një diapazon të ketij përqendrimi që nuk është vetëm sa e specifikoni ju, por që perfshihen edhe vlera të tjera të përqendrimit të lëndës aktive në përbërje të produktit biocid dhe akoma më shumë lëndë aktive të tjera që shërbejnë si dezinfektantë. Në keto kushte sugjerojme që njësia juaj të konsultohet me databasen e ECHA për lëndët aktive dhe me raportët e vlerësimit të këtyre lëndëve ne echa ose assessment report. Njësia duhet të lërë **një diapazon ose interval përqendrimi nga një vlerë minimale e lejuar në një vlerë maksimale të lejuar në përputhje me vlerësimet e bëra në ECHA për ketë lëndë aktive**. Nëse njësia juaj cakton vetëm këto lëndë aktive, edhe kjo nuk është e argumentuar sepse mund të vërë një gamë me të gjerë lëndësh aktive për produktet biocid për përdorim në shëndetin publik ose kombinim të dy, tre ose më shumë lëndësh aktive në një produkt biocid. Caktimi i përqendrimit në (%) të lëndëve aktive dhe i vetë numrit të lëndëve aktive, e drejton tenderin vetëm tek një number i vetëm produktësh biocid, e vetëm në një kompani prodhuese ne botë, duke e bere situatën monopol, pasi kompani të tjera përdorin % të lëndëve aktive me përbërje dhe (%) të ndryshme, etj.

Ky diapazon i ngushtë i % të lëndëve aktive (lëndës aktive), është vendosur qëllimisht që të perfshijë vetëm përbërjen në % të lëndëve ose lëndës aktive në vetëm një produkt biocid, duke paracaktuar në këtë menyrë edhe produktin biocid që do të perdoret. i vetmi ndryshim nga



*caktimi i emri konkret tregëtar të produktit biocid, është vendosja e kriterëve të tilla abuzime pra, produktin biocid nuk e percakton me emrin e tij tregtar (sepse kjo dukshëm nuk lejohet), por e paracakton me faktin e vendosjes se kriterëve të përbërjes se lëndës ose lëndëve aktive specifike të vetëm atij produkti, në % fikse të kësaj lëndë aktive dhe për më tepër duke kërkuar edhe një paketim të caktuar të cilin e ka future në treg një kompani e caktuar. në dukje nuk përcaktohet emri tregëtar, por vendosen përbërja e lëndëve aktive dhe % e lëndëve konkrete që referohen në produkt, që në fakt i ka dhe i plotëson vetëm një produkt apo në numër shumë i vogël produktesh në treg dhe kërkimi i një paketimi strikt të con pikërisht tek një kompani e caktuar, në kundërshtim të plotë kjo me ligjin dhe rregullat e prokurimit public. Kjo është në kundërshtim me ligjin, pasi është diskriminuese dhe kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të interesuar. Kjo vjen në kundërshtim të hapur me nenin 36 të LPP, ...”*

*Kërkojmë - AK duhet të modifikojë specifikimet teknike të produkteve duke lejuar edhe produktet me lëndë aktive ekuivalente me lëndën aktive të kërkuar për cdo produkt nga AK-ja, si dhe të zgjerojë diapazonin për përqindjet e kërkura të lëndëve aktive, referur qëllimit të përdorimit të tyre, me qëllim hapjen e konkurrencës....]*

III.2.1. Autoriteti Kontraktor me Vendimin Nr.743/8 prot., date 10.10.2023 të KSHA-së trajton ankesën me argumentat:

*“Nga konsultimi me specialistet, kjo mishel e lëndëve aktive siguron një efektshmëri të lartë për realizimin e qëllimit tonë. Nga studimi i tregut ka shumë produkte në treg me këtë përzierje lëndësh aktive. Por duke qene se Cypermetrina është dhe lëndë aktive që perdoret në fushën e bujqësisë me % të lartë ( Referuar Lista E Pmb-Ve Të Regjistruara Për-T'u Importuar Dhe Tregtuar Në Republikën e Shqipërisë/Korrik 2023), kemi vendosur këtë kufi % për të qartësuar ofertuesit se do te pranohen vetëm ato produkte për përdorim në fushën e shëndetit publik dhe jo produktet me po këtë lëndë aktive por që destinacion kanë përdorimin në fushën e bujqësisë pasi nëse do përdoren në fushën e shëndetit publik me % të lartë insektet do të krijojnë rezistence ndaj këtyre lëndëve dhe në të ardhmen nuk do të kenë më asnjë efekt në përdorim. Ky është një nga kriteret bazë për ndarjen e përdorimit të produkteve në sektorin e shëndetit publik. Produktet e kërkuara janë të rëndësishme në ushtrimin e detyrave funksionale të Autoritetit Kontraktor. Këto produkte garantojnë marrjen e masave efikase për parandalimin e infeksioneve nga dëmtuesit në shëndetin publik, sipas detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Në këtë rast është kërkuar një përzierje e lëndëve aktive sepse: Substanca kryesore aktive bllokton sistemin nervor të insekteve duke çuar në paralizë dhe në ngordhje të insekteve. Substanca e dytë ndërvepron në temperatura të larta dhe siguron një efekt të shpejtë në ngordhje.*

*Diapazoni është i kufizuar për shkak të rezistencës ndaj lëndëve aktive me % të larta.*

*Ju kujtojmë se jemi një qytet bregdetar ku prania e insekteve për shkak të lagështisë, dhe e mushkonjave në veçanti, është shumë e lartë. Legjislacioni ku ne bazohemi është legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Rregullorja e BE dhe ECHA gjejnë zbatim në vendet e BE-se ku Shqipëria nuk është pjesë, por Legjislacioni jonë ku ne mbështetemi është i përshtatur sipas rregullores se BE dhe ECHA, pasqyruar kjo përse i përket produkteve biocide. Ligji*

*95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 25.11.2020. Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”. Dhe për produktet për përdorim bujqësor LIGJ Nr.105/2016 PËR MBROJTJEN E BIMËVE (ndryshuar me ligjin nr.15/2022, datë 3.2.2022.*

III.2.2. Autoriteti kontraktor ka publikuar në DST:

**Shtoca 5.** [ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

*SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*

NR	EMERTIMI I LENDES AKTIVE	SPECIFIKIME TEKNIKE
1	<b>Insekticid</b> - Cypermethrine 10%	Gjendja fizike i lengshem. Produkt mikro kapsular per efekt te zgjatur. Ambalazhi do jete ne shishe 50-100 ml)
2	<b>Insekticid</b> - Cypermethrine8%-10%+ Tetrametrine 1%-2%	Gjendja fizike i lengshem. Ambalazhi do jete ne shishe 50-100 ml.
3	<b>Rodenticid</b> - Bromadiolone 0,005%	Gjendja fizike-llokum/Block. Ambalazh qese 250 gr
4	<b>Herbicid</b> - Glyphosate 36%	Gjendja fizike I lengshem. Ambalazhi do jete shishe 1Lt

**Data e skadences te jete e dukshme**

**Afati te jete jo me pak se 2 (dy) vit nga data e levrimit.**

**Pesticidet te jene te zhdoganuara.**

III.2.3. Autoriteti Kontraktor me Vendimin Nr.743/8 prot., date 10.10.2023 të KSHA-së trajton ankesën pranon pjesërisht ankesën për modifikime si vijon:

- Ankesa e Operatori Ekonomik Egjan Med shpk pranohet pjesërisht duke modifikuar specifikimet teknike si me poshte:

- Ishte:

NR	EMERTIMI I LENDES AKTIVE	SPECIFIKIME TEKNIKE
1	<b>Insekticid</b> - Cypermethrine 10%	Gjendja fizike i lëngshem. Produkt mikro kapsular per efekt te zgjatur. Ambalazhi do jete ne shishe 50-100 ml)
2	<b>Insekticid</b> - Cypermethrine 8%-10%+ Tetrametrine 1%-2%	Gjendja fizike i lëngshem. Ambalazhi do jetë në shishe 50-100 ml.
3	<b>Rodenticid</b> - Bromadiolone 0,005%	Gjendja fizike-llokum/Block. Ambalazh qese 250 gr
4	<b>Herbicid</b> - Glyphosate 36%	Gjendja fizike i lëngshem. Ambalazhi do jete shishe 1Lt

- Bëhet

NR	EMERTIMI I LENDES AKTIVE	SPECIFIKIME TEKNIKE
1	<b>Insekticid</b> -Cypermethrine 10% ose Insekticid për përdorim në shëndetin publik lëndë aktive ekuivalente, pjesë e listës së VKM-së Nr. 933, datë 25.11.2020 me % jo më të lartë se 10%.	Gjendja fizike i lëngshëm. Produkt mikro kapsular per efekt te zgjatur. Ambalazhi do jete ne shishe 50-100 ml ose në shishe me një sasi lëngu që tretet në jo shumë se 20 litra në ujë.
2	<b>Insekticid</b> -Cypermethrine 8%-10%+ Tetrametrine 1%-2% ose produkte të tjera ekuivalente për përdorim në shëndetin publik lëndë aktive ekuivalente, pjesë e listës së VKM-së Nr. 933, datë 25.11.2020 me % jo më të lartë se 10%.	Gjendja fizike i lëngshem. Ambalazhi do jete ne shishe 50-100 ml ose në shishe me një sasi lëngu që tretet në jo shumë se 20 litra në ujë.
3	<b>Rodenticid</b> -Bromadiolone 0,005% ose për përdorim në shëndetin publik lëndë aktive ekuivalente të gjeneratës së II të antikoagulantëve, pjesë e listës së VKM-së Nr. 933, datë 25.11.2020 me % jo më të lartë se 0,005%.	Gjendja fizike-llokum/Block. Ambalazh qese 50 gr ose 250 gr.
4	<b>Herbicid</b> - Glyphosate 36%	Gjendja fizike i lëngshem. Ambalazhi do jete shishe 1Lt

III. 2.4. Komisioni i Prokurimit Publik referuar akteve të dosjes administrative vëren se, ankimuesi ngre pretendime në ankesë në lidhje me: *[...AK duhet të modifikojë specifikimet teknike të produkteve duke lejuar edhe produktet me lëndë aktive ekuivalente me lëndën aktive të kërkuar për cdo produkt nga AK-ja...]*, autoriteti kontraktor ka pranur të modifikojë specifikimet teknike, cituar sa më sipër, duke përmbushur kërkesën e operatorit ekonomik. Komisioni gjykon se vendimin i KSHA-së për këtë pretendim të ankimuesit është i drejt dhe përmbush kërkesën në lidhje përdorimin e termit ekuivalent, duke mos kufizuar konkurrencën e pjesmarrësve në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.2.5 Në lidhje me pretendimet e ankimuesit [... Ky diapazon i ngushtë i % të lëndëve aktive, është vendosur qëllimisht që të përfshijë vetëm përbërjen në % të lëndëve ose lëndës aktive në vetëm një produkt biocid, duke paracaktuar në këtë menyrë edhe produktin biocid që do të përdoret. i vetmi ndryshim nga caktimi i emri konkret tregëtar të produktit biocid, është vendosja e kriterëve të tilla abuzive pra, produktin biocid nuk e përcakton me emrin e tij tregëtar (sepse kjo dukshëm nuk lejohet), por e paracaktonte me faktin e vendosjes së kriterëve të përbërjes së lëndës ose lëndëve aktive specifike të vetëm atij produkti, në % fikse të kësaj lëndë aktive dhe për më tepër duke kërkuar edhe një paketim të caktuar të cilin e ka futur në treg një kompani e caktuar. AK-ja, të zgjerojë diapazonin për përqindjet e kërkura të lëndëve aktive, referuar qëllimit të përdorimit të tyre, me qëllim hapjen e konkurrencës...]

Komisioni i Prokurimit Publik, referuar pretendimeve të ankimuesit vëren se Komisioni shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 2/d dhe 2/f:

“2. Ankesa duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementet e mëposhtme:

- d) Një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar;
- f) Pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar.”

III.2.6. Referuar legjislacionit të prokurimeve publike Komisioni gjykon se operatori ekonomik, ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë, se ku e bazon pretendimin e tij për specifikimet teknike dhe pse janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për hartimin e kriterëve të dokumenteve të tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë, dhe në vendimmarrjen e tij zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos mbi bazën e pretendimeve të mbështetura në fakte e prova. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyetuara. Gjithashtu Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”. Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “onus probandi incumbit actori” se barra e provës bie mbi ankuesin.

Komisioni i Prokurimit Publik referuar pretendimeve të ankimuesit në lidhje me [...diapazoni i ngushtë i % të lëndëve aktive, është vendosur qëllimisht që të përfshijë vetëm përbërjen në % të lëndëve ose lëndës aktive në vetëm një produkt biocid, duke paracaktuar në këtë...]

në ankesën e paraqitur, gjykon se ankimuesi duhet të identifikonte, se cili është interesi i tij i ligjshëm, që është çenuar dhe cila është shkelja e legjislacionit për prokurimin publik nga autoriteti kontraktor, ndërkohë që ngre pretendime a-priori lidhur me përcaktime të artikujve si produkte të markave të caktuara apo tregëtarëve të caktuar.

Akoma më tej operatori ekonomik ankimues nuk jep shifra konkrete në lidhje me përqindjet e produkteve biocide dhe si ndikojnë ato apo sa efektive janë përqindjet e propozuara prej tij. Pretendime evazive apo apriori pa prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës provues, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë, nuk janë bindëse për të kundërshtuar specifikimet teknike të vendosura në këtë procedurë.

Për sa referuar, pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.3. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi Kriterin për kualifikim, 2.3.5. OE Pjesmarres duhet të paraqesë Certifikatat dhe Analizat si me poshte: a) Çertifikate Analize të mallit. Kërkojmë heqjen e këtij kriteri.

*“...Produktet biocide, insekticide, herbicide kanë një legjislacion të posacëm i cili rregullon, importimin e tyre, marrjen autorizimeve për vendosjen e tyre ne treg nga strukturat përkatëse shtetërore, ku përcaktohet edhe lista e dokumentacionit teknik dhe ligjor që duhet të disponojnë kompanitë cilat duan të importojnë apo tregëtojnë në tregun shqiptar këto produkte në Ligj nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, në nenin 2, neni 8 dhe 9 parashikohet:*

*Neni 2 ky ligj përcakton dhe rregullon: a) vendosjen në treg të lëndëve biocide, produkteve biocide dhe produkteve të trajtuara; b) prodhimin, importin dhe eksportin e lëndëve biocide, produkteve biocide dhe produkteve të trajtuara; c) organizimin dhe funksionimin e kontrollit të organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, në mjediset publike dhe private, përmes produkteve biocide.*

*Neni 8 (autorizimi për bërjen të disponueshme për treg të produkteve biocide)*

*1. Të gjitha lëndët vepruese dhe produktet biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, që hyjnë, prodhohen dhe/ose përdoren në territorin e republikës së shqipërisë, bëhen të disponueshme për treg pas pajisjes me autorizim nga autoriteti kompetent.*

*2. Autoriteti kompetent autorizon produktet biocide, duke lejuar bërjen të disponueshme për treg në territorin e republikës së shqipërisë, pas paraqitjes së dokumentacionit nga personi fizik ose juridik dhe verifikimit nëse dosja i përmbush kërkesat, sipas këtij ligji.*

*3. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, për raste të gjendjeve të emergjencës shëndetësore apo emergjencës civile, kur luftimi i një agjenti biologjik të dëmshëm gjykohet se nuk realizohet me produktet biocide të autorizuar, autorizon importimin dhe përdorimin e kufizuar të produkteve biocide të paautorizuara përmes procesit normal të bërjes së disponueshme për treg. autorizimi është i vlefshëm për një periudhë deri në 4 muaj dhe për një sasi të argumentuar nga instituti i shëndetit publik, sipas emergjencës.*

*4. Autorizimi për vendosjen në treg të produkteve biocide lëshohet për: a) produkte biocide të prodhuara në vend; b) produkte biocide të autorizuar në njërin nga vendet e BE, në Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Turqi, Izrael dhe Australi; c) produktet biocide të prodhuara dhe të autorizuar në vendet e ballkanit.*

*5. Rregullat për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedurën e dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide përcaktohen me VKM.*

*Neni 9, 1. Produktet biocide vendosen në treg pasi janë autorizuar, sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.*

2. Vendosja në treg e produkteve biocide kryhet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, të cilët, pavarësisht nga sasia e produktit, plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë të kontraktuar një person, në pozicionin e drejtuesit teknik, të diplomuar në degët biologji, kimi, agronomi ose shëndet publik;

b) kanë mjedise të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit, garantojnë kushte për sigurinë e personelit;

c) kanë klasifikuar, paketuar dhe etiketuar produkte biocide, sipas dokumentacionit të autorizimit të produktit; ç) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë mjedise të veçanta tregtimi.

Në kreun 3 të VKM nr. 933, datë 25.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg", parashikohet shprehimisht se:

1. Dosja e aplikimit për autorizim për vendosjen në treg të produkteve biocide, së bashku me kërkesën për pajisjen me autorizim, përmban dokumentet e mëposhtme:

a) Një dosje dhe letër aksesi për produktin biocid, që plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën II të këtij vendimi;

b) Një përmbledhje të karakteristikave të produktit biocid, përfshirë: - emrin tregtar të produktit biocid; - emrin dhe adresën e aplikantit; - përbërjen cilësore e sasiore të produktit lidhur me lëndët vepruese dhe lëndët e tjera jovepruese, si dhe njohuri të domosdoshme për përdorimin e duhur të produktit biocid; - prodhuesit e produktit biocid (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit); - prodhuesit e lëndëve vepruese (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit); - tipi i formulimit të produktit biocid; - frazat e rrezikut dhe parandalimit; - tipi i produktit biocid dhe një përshkrim i saktë i përdorimit për të cilin kërkohet autorizimi; - organizmat target; - dozat e aplikimit dhe udhëzimet për përdorimin; - kategoritë e përdoruesve; - të dhëna mbi ndikime të mundshme direkte apo indirekte të produktit biocid në mjedis dhe përcaktimin e masave përkatëse për minimizimin e këtyre ndikimeve në mjedis; - udhëzues për nxjerrjen e sigurt jashtë përdorimit të produktit dhe ambalazhit; - kushtet e ruajtjes dhe jetën e ruajtjes së produktit biocid për kushte normale të ruajtjes; - informacion tjetër relevant rreth produktit biocid. c) një dosje dhe letër aksesi për çdo lëndë vepruese të miratuar, që përmbahet në produktin biocid, që plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën I të këtij vendimi; ç) letra e aksesit duhet të përmbajë së paku informacionin e mëposhtëm: - emrin dhe detajet e kontaktit të zotëruesit të të dhënave dhe personit të tretë; - emrin e substancës vepruese ose të produkteve biocide për të cilat është i autorizuar përdorimi i të dhënave; - datën në të cilën letra e aksesit hyn në fuqi; - një listë të të dhënave të paraqitura për të cilat letra e aksesit i jep të drejtën e citimit. d) aplikanti nuk ka nevojë të paraqesë të dhëna për ekspozimin, nëse nuk parashikohet ekspozim që shoqëron përdorimet e propozuara dhe nuk është e nevojshme shkencërisht që të paraqiten të dhëna, apo nuk është teknikisht e mundur që të prodhohen të dhëna të tilla; dh) të dhënat që provojnë se produkti biocid është i autorizuar në një nga vendet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 8, të Ligjit nr. 95/2015, dhe është i përfshirë në bazën e të dhënave të agjencisë evropiane të kimikateve për produktet biocide të autorizuar. aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që zotëron autorizimin e këtij produkti biocid, të

përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe; e) për produktet biocide që janë subjekt i procedurës së thjeshtuar të autorizimit, sipas përcaktimeve në kreun IV, të shtojcës i, të këtij vendimi: - një përmbledhje të karakteristikave të produktit biocid, sipas referimit në pikën 1(a) të këtij kreu; - të dhënat e efikasitetit; dhe - çdo informacion tjetër relevant në mbështetje të konkluzionit se produkti biocid plotëson kushtet e përcaktuara në kreun iv të këtij vendimi; - të dhënat që provojnë se aplikantit i është lëshuar autorizimi i produktit biocid në një nga vendet e BE ose aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që e ka marrë autorizimin e këtij produkti biocid në një nga vendet e bashkimit evropian; të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe. ë) etiketën përkatëse të produktit biocid, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 487, datë 29.6.2016, të këshillit të ministrave, “Për klasifikimin e produkteve biocide”; f) dokumentacioni me të dhënat e sigurisë (msds) për produktet biocide në gjuhën shqipe dhe angleze, në formë të printuar dhe elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kimikatet. g) mostrën e produktit biocid me paketimin dhe etiketën në gjuhën shqipe, siç do të hidhet në treg; gj) Licencën e QKB-së për vendosjen në treg të produkteve biocide; h) Lejen mjedisore, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas shtojcës 1, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar; i) Faturën e pagesës së aplikimit.

Rregullim i posaçëm është parashkuar edhe në Ligjin nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, në lidhje me vendosjen në treg të produkteve për mbrojtjen e bimeve dhe në asnjë dispozitë të këtij ligji nuk është e përcaktuar se OE të cilët do të vendosin në treg këto produkte duhet që në dokumentacionin përkatës të paraqesin edhe certifikatat e analizave apo flet analizat e këtyre produkteve.

Referuar ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publikë dhe VKM nr. 933, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, Ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, për produktin produktet objekt prokurimi, për pajisen me dokumentacion përkatës dhe vendosjen e tij në treg në Republikën e Shqipërisë ka një rregullim specifik ligjor dhe për pasojë AK nuk mund të kërkojë për këto produkte dokumentacion shoqërues të ndryshëm nga sa parashikon ligji i posaçëm, pasi në këtë mënyrë krijon konfuzion dhe paqartësi tek OE të cilët kërkojnë të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi dhe për më tepër kufizon pjesmarrjen.

Për sa kohë ligji i posaçëm nuk kërkon raport analizash për këtë produkte si një nga dokumentat që duhet të jenë në dosjen e aplikantit për të marrë autorizimin për vendosjen në treg të tyre, një kërkesë e tillë në këtë moment pengon pjesmarrjen e OE në këtë procedurë prokurimi pasi në Shqipëri nuk ka asnjë laborator të akredituar që mund të bëjë këto lloj analizash, kurse dërgimi jashtë vendit për të bërë këto analiza jo vetëm shton kostot por dhe nuk është i mundur të realizohet në kohën e duhur për të marrë pjesë në këtë tender.

III.3.1 Autoriteti Kontraktor me Vendimin Nr.743/8 prot., date 10.10.2023 të KSHA-së trajton ankesën me argumentat:

“ Ju sqarojmë si me poshtë vijon: certifikata e analizës së mallit, ashtu si dhe certifikata e origjinës kërkuar të dyja në piken 2.3.5 të DST, është një dokument që e lëshon prodhuesi dhe është analiza e thjeshtë që tregon vetitë fizike dhe kimike të produktit të prodhuar, është dokument shoqërues i mallit deri në blerësin përfundimtar, për shkak se produktet biocide dhe

herbicide janë objekt i vazhdueshëm kontrolli nga Inspektoriati Shëndetesor, sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 95/2015 dhe sipas nenit 38, të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit sipas përcaktimeve të Ligj Nr. 105/2016 “Për Mbrojtjen e Bimëve” dhe janë objekt i procedurës së inspektimit në Pikat e Inspektimit Kufitar.

Ligji 95/2015 “PËR SHËRBIMET DHE PRODUKTET BIOCID NË SHËNDETIN PUBLIK, KREU V, “KONTROLLI DHE MONITORIMI I ZBATIMIT TË LIGJI”.

Neni 20

#### Kontrolli dhe monitorimi

1. Kontrolli për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, në pikat e prodhimit në vend, në degët doganore, në pikat e ruajtjes dhe në pikat e vendosjes në treg, kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetit.

2. Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit, në zbatim të këtij ligji dhe të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ka këto përgjegjësi:

a) Të inspektojë hapësirat, objektet, aparaturat, pajisjet dhe dokumentacionin e personave fizikë ose juridikë që ofrojnë shërbime të produkteve biocide në shëndetin publik;

b) Të kontrollojë gjendjen fiziko-kimike të produktit biocid dhe të marrë mostra të produkteve biocide, sipas nenit 38, të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;

c) Të verifikojë nëse produktet biocide janë të autorizuar ose jo, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj;

ç) të kontrollojë nëse produktet biocide janë bërë të disponueshme për treg, në përputhje me kërkesat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;

d) të kontrollojë nëse produktet biocide të vendosura në treg janë klasifikuar, paketuar dhe etiketuar sipas kërkesave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; dh) të kontrollojë nëse subjekti është i licencuar sipas legjislacionit në fuqi;

e) Të vendosë për asgjësimin e produktit biocid, sipas legjislacionit në fuqi, nëse konstatohet se produkti biocid është hedhur në treg i paautorizuar dhe është jashtë periudhës së përdorimit.

3. Në rastet kur produkti biocid importohet, verifikimi dhe vlerësimi i dokumenteve shoqëruese të tij në pikat e kalimit kufitar është i detyrueshëm dhe kryhet nga përfaqësuesit e inspektoratit që mbulon fushën e shëndetit dhe autoriteteve doganore, sipas kompetencave përkatëse.

4. Instituti i Shëndetit Publik është struktura përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të këtij ligji. **Pavaresisht pajisjes me Autorizim për vendosje në Treg të produkteve biocide dhe Certifikate regjistrimi/ numër regjistrimi të produkteve herbicide, nuk lejohet futja e tyre në treg nëse në dokumentacionin shoqërues nuk është certifikata e analizës dhe origjinës.**

Ne si AK nuk kërkojmë raport testimi apo certifikim të organeve kompetente të akredituara. AK kërkon certifikatë të thjeshtë të analizës së mallit e cila ashtu si certifikata e origjinës janë dokumenta të domosdoshëm për të siguruar AK për karakteristikat teknike të produkteve të kërkuara sic është gjendja fizike e përcaktuar dhe % e lëndëve për ti ballafaquar me dokumentat e tjera të kërkuara që OE ofertues do të paraqesë. Kjo certifikatë lëshohet nga prodhuesi dhe kjo analizë kryhet për çdo lot të prodhuar në laboratorët e prodhuesit dhe jo nga të tretë. Kontrolli i cilësisë së produkteve biocide dhe herbicide nuk përfundon me marrjen e Autorizimit për Vendosjen në Treg të Produkteve Biocide apo për pajisjen me Certifikate Regjistrimit e produkteve herbicide, kjo pasi autorizimi meret për një kohë të caktuar dhe importi nuk ka një



*numër të kufizuar, pra nuk bëhet vetëm një herë. Ky dokument mund të sigurohet nga distributori lehtësisht në rastet se importi i produkteve objekt prokurimi është bërë rregullisht dhe konform legjislacionit në fuqi duke kaluar me sukses kontrollin në pikat kufitare bashkë me dokumentacionin shoqërues sipas legjislacionit në fuqi, ashtu si autorizimi i distributorit i kërkuar në DST, mostra dhe certifikata e Origjinës e kërkuar në DST, dhe jo në mënyra të tjera të jashtëligjshme.*

III.3.2. Në dokumentet e tendetit, 2.3 Kapaciteti teknik: pika 2.3.5 OE Pjesëmarrës duhet të paraqesë Certifikatat dhe Analizat si me poshtë:

- a) Certifikatë Analize të mallit
- b) Çertifikate Origjinë të mallit
- c) Çertifikatë Regjistrimi nga Ministria e Bujqesisë për produktet me përdorim bujqesor dhe License Importi per produktet me perdorim DDD,te Autorizuesit
- d) Autorizim te Ministrise se Shendetsise per importimin e lendeve te D.D.D,te Autorizuesit
- e) Autorizim Distributori
- f) License e Kodi II.8.B, Sherbime Nderhyrese Higjeno-Shendetsore leshuar nga QKB.

III.3.3 Autoriteti Kontraktor në Procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” ka argumentuar:

*Analizat e leshuara nga institucione te autorizuar qe vertetojne pajtushmerine e produkteve me specifikimet teknike. Analizat te jene te vitit 2021-2022 per artikujt e kerkuara.*

**Argumentim:** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.*

III.3.4. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

**III.3.5. Neni 40, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :**

*“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.3.6. Në Ligj nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, në nenin 2, 8, 9 parashikohet: “Neni 2 Ky ligj përcakton dhe rregullon:

- a) vendosjen në treg të lëndëve biocide, produkteve biocide dhe produkteve të trajtuara;
- b) prodhimin, importin dhe eksportin e lëndëve biocide, produkteve biocide dhe produkteve të trajtuara;
- c) organizimin dhe funksionimin e kontrollit të organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, në mjediset publike dhe private, përmes produkteve biocide.

Neni 8. Autorizimi për bërjen të disponueshme për treg të produkteve biocide

1. Të gjitha lëndët vepruese dhe produktet biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, që hyjnë, prodhohen dhe/ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen të disponueshme për treg pas pajisjes me autorizim nga autoriteti kompetent.

2. Autoriteti kompetent autorizon produktet biocide, duke lejuar bërjen të disponueshme për treg në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas paraqitjes së dokumentacionit nga personi fizik ose juridik dhe verifikimit nëse dosja i përmbush kërkesat, sipas këtij ligji.

3. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, për raste të gjendjeve të emergjencës shëndetësore apo emergjencës civile, kur luftimi i një agjenti biologjik të dëmshëm gjykohet se nuk realizohet me produktet biocide të autorizuar, autorizon importimin dhe përdorimin e kufizuar të produkteve biocide të paautorizuara përmes procesit normal të bërjes së disponueshme për treg. Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë deri në 4 muaj dhe për një sasi të argumentuar nga Instituti i Shëndetit Publik, sipas emergjencës.

4. Autorizimi për vendosjen në treg të produkteve biocide lëshohet për:

- a) produkte biocide të prodhuara në vend;
- b) produkte biocide të autorizuar në njërin nga vendet e Bashkimit Europian, në Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Turqi, Izrael dhe Australi;
- c) produktet biocide të prodhuara dhe të autorizuar në vendet e Ballkanit.

5. Rregullat për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedurën e dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9. 1. Produktet biocide vendosen në treg pasi janë autorizuar, sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Vendosja në treg e produkteve biocide kryhet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, të cilët, pavarësisht nga sasia e produktit, plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë të kontraktuar një person, në pozicionin e drejtuesit teknik, të diplomuar në degët biologji, kimi, agronomi ose shëndet publik;
- b) kanë mjedise të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit, garantojnë kushte për sigurinë e personelit;
- c) kanë klasifikuar, paketuar dhe etiketuar produkte biocide, sipas dokumentacionit të autorizimit të produktit;
- ç) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë mjedise të veçanta tregtimi.”

III.3.7. Në Kreun 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Dosja e aplikimit për autorizim për vendosjen në treg të produkteve biocide, së bashku me kërkesën për pajisjen me autorizim, përmban dokumentet e mëposhtme:

a) Një dosje dhe letër aksesi për produktin biocid, që plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën II të këtij vendimi;

b) Një përmbledhje të karakteristikave të produktit biocid, përfshirë:

- emrin tregtar të produktit biocid; - emrin dhe adresën e aplikantit;
- përbërjen cilësore e sasiore të produktit lidhur me lëndët vepruese dhe lëndët e tjera jovepruese, si dhe njohuri të domosdoshme për përdorimin e duhur të produktit biocid;
- prodhuesit e produktit biocid (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit);
- prodhuesit e lëndëve vepruese (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit);
- tipi i formulimit të produktit biocid;
- frazat e rrezikut dhe parandalimit;
- tipi i produktit biocid dhe një përshkrim i saktë i përdorimit për të cilin kërkohet autorizimi;
- organizmat target;
- dozat e aplikimit dhe udhëzimet për përdorimin;
- kategoritë e përdoruesve;
- të dhëna mbi ndikime të mundshme direkte apo indirekte të produktit biocid në mjedis dhe përcaktimin e masave përkatëse për minimizimin e këtyre ndikimeve në mjedis;
- udhëzues për nxjerrjen e sigurt jashtë përdorimit të produktit dhe ambalazhit;
- kushtet e ruajtjes dhe jetën e ruajtjes së produktit biocid për kushte normale të ruajtjes;
- informacion tjetër relevant rreth produktit biocid.

c) Një dosje dhe letër aksesi për çdo lëndë vepruese të miratuar, që përmbahet në produktin biocid, që plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën I të këtij vendimi;

ç) Letra e aksesit duhet të përmbajë së paku informacionin e mëposhtëm:

- emrin dhe detajet e kontaktit të zotëruesit të të dhënave dhe personit të tretë;
- emrin e substancës vepruese ose të produkteve biocide për të cilat është i autorizuar përdorimi i të dhënave;
- datën në të cilën letra e aksesit hyn në fuqi;
- një listë të të dhënave të paraqitura për të cilat letra e aksesit i jep të drejtën e citimit.

d) Aplikanti nuk ka nevojë të paraqesë të dhëna për ekspozimin, nëse nuk parashikohet ekspozim që shoqëron përdorimet e propozuara dhe nuk është e nevojshme shkencërisht që të paraqiten të dhëna, apo nuk është teknikisht e mundur që të prodhohen të dhëna të tilla;

dh) Të dhënat që provojnë se produkti biocid është i autorizuar në një nga vendet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 8, të ligjit nr. 95/2015, dhe është i përfshirë në bazën e të dhënave të Agjencisë Evropiane të Kimikateve për produktet biocide të autorizuar. Aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që zotëron autorizimin e këtij produkti biocid, të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe;

e) Për produktet biocide që janë subjekt i procedurës së thjeshtuar të autorizimit, sipas përcaktimeve në kreun IV, të shtojcës I, të këtij vendimi:

- një përmbledhje të karakteristikave të produktit biocid, sipas referimit në pikën 1(a) të këtij kreu;

- të dhënat e efikasitetit; dhe
- çdo informacion tjetër relevant në mbështetje të konkluzionit se produkti biocid plotëson kushtet e përcaktuara në kreun IV të këtij vendimi;
- të dhënat që provojnë se aplikantit i është lëshuar autorizimi i produktit biocid në një nga vendet e Bashkimit Evropian ose aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që e ka marrë autorizimin e këtij produkti biocid në një nga vendet e Bashkimit Evropian; të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe.
- ë) Etiketën përkatëse të produktit biocid, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 487, datë 29.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e produkteve biocide”;
- f) Dokumentacioni me të dhënat e sigurisë (MSDS) për produktet biocide në gjuhën shqipe dhe angleze, në formë të printuar dhe elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kimikatet.
- g) Mostrën e produktit biocid me paketimin dhe etiketën në gjuhën shqipe, siç do të hidhet në treg;
- gj) Licencën e QKB-së për vendosjen në treg të produkteve biocide;
- h) Lejen mjedisore, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas shtojcës 1, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;
- i) Faturën e pagesës së aplikimit.”

III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit si dhe ka detyrë të përcaktojë kritere dhe specifikime teknike që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit

Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi heqjen e kritereve të veçanta të kualifikimit e në veçanti të kërkesës: *2.3.5 OE Pjesemarrës duhet të paraqesë Certifikatat dhe Analizat si me poshte:*

*a) Çertifikate Analize të mallit*

në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me objektin e kontratës dhe qëllimi e për të cilin do të prokurohet malli, në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës dhe ofrojnë produkte cilësore, në funksion të përmbushjes së këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimin të specifikimeve teknike të produkteve. Në interpretim të dispozitave ligjore të fushës së prokurimit, vlen të theksojmë se së pari, ligjvënësi ka parashikuar dy natyra kritereesh kualifikimi, kritere të cilat përcaktohen me ligj, si dhe kritere dhe kërkesa të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në përputhje me llojin, volumin, sasinë, specifikat e shërbimit që kërkohet të prokurohet, me qëllim realizimin me sukses dhe cilësi të tij. Referuar procedurës konkrete objekt-shqyrtimi, konstatojmë se blerja e mallit nga subjektet të cilat ofrojnë shërbimin objekt-

prokurimi, ka një rregullim të posaçëm ligjor dhe kryhet sipas disa procedurave specifike, duke u shoqëruar me dokumentacion përkatës, për vendosjen e tyre në treg (Ligji 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe rregullat në zbatim të tij).

III.3.9. Referuar ankesës: [*...Për sa kohë ligji i posaçëm nuk kërkon raport analizash për këto produkte si një nga dokumentat që duhet të jenë në dosjen e aplikantit për të marrë autorizimin për vendosjen në treg të tyre, një kërkesë e tillë në këtë moment pengon pjesmarrjen e OE në këtë procedurë prokurimi pasi në Shqipëri nuk ka asnjë laborator të akredituar që mund të bëjë këto lloj analizash, kurse dërgimi jashtë vendit për të bërë këto analiza jo vetëm shton kostot por dhe nuk është i mundur të realizohet në kohën e duhur për të marrë pjesë në këtë tender...*]Komisioni vëren se operatori ekonomik argumenton qartë ankesën e tij mbi modifikim të kriterit 2.3.5/a. duke iu referuar legjislacionit përkatës mbi produktet biocide.

Komisioni i Prokurimit Publik referuar dokumenteve të dosjes administrative, e në veçanti objektit të prokurimit, qëllimi i të cilit është përdorimit të produkteve pesticide për dizinfektim, gjykon se është në të drejtën e autoritetit kontraktor të sigurohet për cilësinë e preparateve që do të përdoren, për efikasitetin e tyre në arritjen e qëllimit. Dezinfektimi i ambienteve të cilat ndikojnë në shëndetin e popullatës është përgjegjësi e institucioneve përkatëse që ta kryejnë atë me cilësi dhe në funksion të qëllimit autoriteti kontraktor duhet të kërkojë dokumentacionin e duhur e në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Referuar Ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe rregullat në zbatim të tij, produktet për kryerjen e shërbimit objekt-prokurimi, pajisen me dokumentacion përkatës për vendosjen e tyre në treg në Republikën e Shqipërisë dhe duke qenë se për këtë procedurë ka një rregullim specifik, autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë për këto produkte dokumentacion shoqëruar të ndryshëm nga sa parashikon ligji i posaçëm, pasi në këtë mënyrë krijon konfuzion dhe paqartësi tek operatorët ekonomikë të cilët kërkojnë të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin në lidhje me dokumentacionin e kërkuar në pikën 2.3.5/ a, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës përkatëse, më qëllim për të siguruar një pjesëmarrje sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë.

Pretendimet e ankimuesit për këtë pikë qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.

500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-81573-09-28-2023, me objekt: “Blerje Pesticide”, me fond limit 1.998.000 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 09.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale, Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**